Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 7237
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 05/03 2024
KAMENICË/A

IAAP „ Andrea Durrsaku "
Nr.397 dt. 05.03.2024
Kamenicë

Në bazë të nenit 28 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-138 të datës 18.03.2013 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe në bazë të nenit 12 të Ligjit nr.04/L-143, të datës 13.10.2012, për arsimin dhe aftësimin e të rriturve, drejtoria e Institucionit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional "Andrea Durrsaku"shpall:

# K O N K U R S

## PËR REGJISTRIM NË ARSIMIN PËR TË RRITUR-AFATI I MAJIT 2024

IAAP„Andrea Durrsaku"shpall konkursin për regjistrim në arsmin për të rritur, për kandidatët të cilët kanë mbaruar shkollimin fillor të obligueshëm ose kanë mbaruar ndonjë vit të shkollës së mesme.

- Për regjistrim mund të konkurojn kandidatët të cilët i kanë mbushur 18 vjet.
- Kandidatët e interesuar të cilët i plotësojn kushtet e parapara me këtë konkurs mund të regjistrohen në klasën e X,XI,XII në drejtime dhe profile si në tabelë:

| Nr | Drejtimi | Profili arsimor | Vende të lira |
|---|---|---|---|
| 1 | Elektroteknikë | Informatikë | 16 |
| | | Telekomunikacion | 16 |
| | | Energjitikë | 16 |
| 2 | Makineri | Automekanik | 16 |
| | | Mekanik i makinave | 16 |
| 3 | Makineri,prodhim dhe ndërtimtari | Instalues i UK-NK | 16 |
| | | Metalpunues | 16 |
| | | Instalues elektrik | 16 |
| | | Ndërtimtari | 16 |
| | | Arkitekturë | 16 |
| 4 | Kimiko teknologjik | Laborant i kimisë | 16 |
| 5 | Ekonomi | Banka dhe sigurime | 16 |
| | | Kontabilist | 16 |
| 6 | Administratë | Asistent i administratës | 16 |

- Regjistrimi i vijuesve në programin "Arsimi për të rritur", bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt,siç është paraparë në Ligjin nr.04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve Administrative të MASHTI-it.
- Në programin "Arsimi për të rritur" në shkollat e mesme të larta, vijuesvee ju mundësohet që një vit të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18 javë mësimi.në bazë të Udhëzimit Administrativ 13/2014 të datës 05.05.2014

- **Kandidatët për regjistrim duhet t'i dorëzojn këto dokumente:**:
- Dëftesë  mbi kryerjen e shkollimit fillor të obligueshëm (kandidatët që kanë të kryer ndonjë klasë të shkollës mesme duhet të dorëzojn dëftesen e klasës së fundit).
- Çertifikatë e lindjes

- Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë për këta vijues është me pagesë

Participimi bëhet në bazë të rregullores nr. 01/2017 të nenit 12 të datës 02.02.2017 për Planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur

- **Pagesa e rexhistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur**

a) Për regJistrimin të vitit ( për një klasë 100 € ) ................................ **100 €**
b) Për praktikë profesionale.................................................................. **50 €**
c) Provim diferencial........................................................................... **10 €**
d) Provim pëfundimtar-diploma........................................................... **50 €**

- Pagesa bëhet në institucionet përkatse sipas kodit të shkollës
- Vijuesit të cilët ndërrojnë profilin, do t'u nënshtrohen provimëve diferenciale, bazuar në UA 13/2014 ,dt: 05.05.2014 të MASHTI. Kandidatët, të cilët ndërrojnë drejtimin , janë të obliguar që paraprakisht t'u nënshtrohen provimëve plotësuese dhe diferenciale.
- Dhënia e provimëve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë
- Dëftesat dhe diplomat që merren në programin "Arsimi dhe aftësimi për të rritur " janë të barasvleshme me diplomat e arsimit profesional.
- Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik

u.d. ____________
Fadil Gashi